


Bibël për fëmijët

paraqet

Davidi Bariu i Ri



Shkruar nga: Edward Hughes

Ilustruar nga: Lazarus

Adaptuar nga: Ruth Klassen

Alastair Paterson

Përkthyer nga: Arianit & Valbona Iljazi

Prodhuar nga: Bible for Children

www.M1914.org

BFC

PO Box 3

Winnipeg, MB R3C 2G1


Canada

©2020 Bible for Children, Inc.


E drejta e kopjimit: Mund të bëni kopje ose ta shtypni këtë histori,
nëse nuk do ta shitni.



Shumë kohë më parë në ditët e Mbretit Saul të Izraelit, një djalë i quajtur David ndihmonte të shtatë vëllezërit e tij për tu kujdesur për delet e babait të tyre.



Megjithëse ishte më i riu, Davidi ishte një djalë trim dhe i fortë që donte dhe besonte Perëndinë. Ai jetonte në qytetin e Bethlehemit.



Njëherë një luan sulmoi grigjën për të përllarë një qengj të vogël për darkë. Davidi i ri e sulmoi gllabëruesin. Duke e tërhequr qengjin nga goja e luanit, ai e kapi bishën nga krifa dhe e vrau. Davidi e dinte që Perëndia e kishte ndihmuar.



Samueli, profeti i Perëndisë,
ishte ende i trishtuar që
Mbreti Sauli kishte përbuzje
ndaj Perëndinë. "Gjer kur do të
vajtosh për Saulin?" e qortoi
Perëndia Saulin.



"Unë po të dërgoj tek Jese...Sepse unë kam përzgjedhur për VETEN TIME, një mbret ndër bijtë e tij". Jese ishte babai i Davidit. Megjithëse e dinte se mbreti Saul mund ta vriste pse po shkonte të gjente një mbret tjetër, profeti iu bind Perëndisë.





Kur Samueli mbërriti,
Jese bëri që shtatë nga
bijtë e tij të kalojnë
përpara Samuelit. Dhe
Samueli i tha Jeses,
"Perëndia nuk ka zgjedhur
asnjë nga këta". I vetmi
që kishte mbetur ishte
Davidi, më i ri. Ai ishte
jashtë me delet. Ata e
sollën Davidin brenda.
Dhe Perëndia tha, "Çohu
vajos atë; se ky është ai".




Në pallatin e Saulit, Fryma e Perëndisë
ishte larguar nga Sauli dhe ai ishte shumë i


turbulluar. Shërbëtorët e
tij menduan se një muzikë
e mirë do të mund të
qetësonte mendjen e
Saulit. Njëri nga ata
njihte një djalë të
ri që i binte shumë
bukur harpës. A
e gjeni dot se
kush ishte ky
djali i ri? Po,
Davidi.




Muzika e Davidit e qetësonte Saulin dhe e ndihmonte për të menduar drejt. Sauli i kërkoi Jese ta linte Davidin në shërbimin e Mbretit. Kurdo që Sauli kishte një episod depresioni ose frike, Davidi i binte harpës për të. Kjo ndihmonte.



Pasi Davidi shkoi në shtëpi, Sauli kishte një betejë të madhe me Filistenjtë. Vëllezërit e Davidit luftonin në ushtritë e Saulit. Jese e dërgoi Davidin drejt frontit të betejës për ti çuar ushqim vëllezërve të tij dhe të merrte vesh se si ishin ata.



Goliathi, një Filiste gjigand i MADH, i kishte frikësuar të gjithë ushtarët e Izraelit.




"Zgjidhni një njeri ndër ju, dhe silleni këtu poshtë tek unë", bërtiste Goliathi. "Nëse ai është i aftë të luftojë dhe të më vrasë mua, atëherë ne do të jemi shërbëtorët tuaj. Por nëse unë e vras atë, atëherë ju duhet të bëheni shërbëtorët tanë dhe do na shërbeni".

Të gjithë
njerëzit e

Izraelit ia
mbathën larg
tij dhe ishin
tmerrësisht të
frikësuar.




Atëherë Davidi i tha Saulit, "Le të mos ligështohet zemra e askujt për shkak të tij; shërbëtori yt do të shkojë dhe do të luftojë me këtë Filiste". Sauli donte që Davidi të vishte parzmore dhe të mbante një shpatë. Përkundrazi, Davidi mori hoben e tij dhe pesë gurë të lëmuar nga përroi.




Goliathi qeshi kur ai pa që Davidi i ri nuk kishte veshur madje as armaturë. "Unë do t'ja jap mishin tënd zogjve të qiellit dhe bishave të fushës", ulëriti ai. "Unë vij kundër teje në emër të Perëndisë", u përgjigj Davidi. "Këtë ditë Perëndia do të të dorëzojë ty në duart e mia...sepse beteja i takon Perëndisë".



Atëherë Davidi
vrapoi ti dalë
përballë Goliathit.
Ndërsa vraponte
lëshoi një gur me
hoben e tij - drejt
e në ballin e
Goilathit. Goliathi
ra përtokë.







Davidi me shpejtësi ia hoqi shpatën
Goliathit dhe ia preu kokën. Kur
Filistenjtë e panë Goliathin të
vdekur, ata ia mbathën nga sytë
këmbët për të shpëtuar
jetën e tyre.



Mbreti Saul nuk e kujtoi që ky ishte i njëjti David që e qetësonte me harpë. Ai e vuri Davidin në krye të ushtrisë së tij - pastaj u bë xheloz kur populli nderonte fitoret e Davidit.

Sauli filloi të mendojë, "Çfarë i mungon atij tjetër përveç mbretërisë"? Kështu që prej asaj dite, Sauli nuk e shihte me sy të mirë Davidin.





Por Jonathani, biri i Saulit, e donte si vëlla Davidin. "Ati im, Sauli kërkon të të vrasë", e paralajmëroi ai Davidin. Kështu Davidi ia mbathi. Gruaja e tij vuri një si kukull në shtratin e tij, dhe e zbriti Davidin poshtë nga dritarja në mes të natës. Kur erdhën njerëzit e Saulit në mëngjes, Davidi kishte ikur.



Davidit iu desh të ikte larg prej Saulit. Përpara se të ikte, ai dhe Jonathani bënë një besëlidhje së bashku. Ata premtuan se do ta ndihmonin gjithmonë njëri-tjetrin.



Shumë të trishtuar, të dy miqtë thanë mirupafshim.
Davidi doli dhe filloi të kërkojë një vend ku të
jetonte pa frikë se mos ushtarët po e gjenin.



Davidi Bariu i Ri

Një tregim nga Fjala e Perëndisë, Bibla


e marrë nga

1 Samuelit 16-20


"Zbulimi i fjalëve të tua ndriçon dhe u
jep mendje njerëzve të thjeshtë."

Psalmet 119:130





19



60



Ky tregim nga Bibla na tregon për Perëndinë tonë të
mrekullueshëm i cili na krijoi dhe dëshiron që
ne ta njohim Atë.

Perëndia e di që ne kemi bërë gjëra të këqija, të cilat Ai i quan
mëkate. Dënimi për mëkatin është vdekja, por Perëndia ju do juve
aq shumë sa që dërgoi Birin e Tij të vetëm, Jezusin, që të vdesë në
Kryq dhe të dënohet për mëkatet tuaja. Pastaj Jezusi u ringjall
dhe u ngrit lart në Qiell! Nëse beson në Jezusin dhe i kërkon Atij
të t'i falë mëkatet e tua, Ai do ta bëj atë! Ai do të vijë dhe do të
jetojë në ty, dhe ti do të jetosh me Të përgjithmonë.

Nëse ti beson se kjo është e vërteta, drejtoju Perëndisë kështu:
Jezus i dashur, unë besoj se Ti je Perëndia i bërë njeri për të
vdekur për mëkatet e mia, dhe që Ti u ngjalle sërish. Të lutem,
eja në jetën time dhe fali mëkatet e mia, në mënyrë që unë të kem
jetë të re dhe një ditë të jem me Ty, përgjithmonë. Më ndihmo,
të të bindem dhe jetoj për Ty, si fëmija Yt. Amen.

Lexo Biblën dhe bisedo me Perëndinë çdo ditë! Gjoni 3:16

